

LIGJ
Nr. 82/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, QË NDRYSHON
MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË PROGRAMIN E DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit, që ndryshon memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së Bashkimit Evropian, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.11.2018

Shpallur me dekretin nr. 10981, datë 27.11.2018, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

KOMISIONI EVROPIAN

Bruksel, 11.1.2018
C (2018) 48 përfundimtar

Shtojcë e vendimit të Komisionit, që miraton në emër të Bashkimit Evropian një Memorandum Mirëkuptimi për ndryshimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë së BE-së, lidhur me objektivin që lidhet me lëndët narkotike të Programit të Drejtësisë së BE-së.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
QË NDRYSHON MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, MBI
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E DREJTËSISË SË
BASHKIMIT EVROPIAN

Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si Shqipëria nga njëra anë, dhe Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “Komisioni”, në emër të Bashkimit Evropian, nga ana tjetër,

bashkërisht të referuar si “Palët”,
duke pasur parasysh se:

1. Marrëveshja Kuadër ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, e cila vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e BE-së, është miraturar më 22

nëntor 2004 dhe ka hyrë në fuqi më 11 korrik 2005¹ (në vijim e referuar si “Marrëveshja Kuadër”), duke i lejuar Komisionit dhe autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë të caktojnë afatet dhe kushtet specifike, përfshirë kontributin financiar në lidhje me një pjesëmarrje të tillë në çdo program të veçantë;

2. Programi i Drejtësisë është krijuar me Rregulloren (EU) nr. 1382/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013²;

3. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë së BE-së u nënshkrua më 28 shtator 2016, me përjashtim të objektivit që lidhet me lëndët narkotike të Programit të Drejtësisë të BE-së;

4. Palët kanë vullnetin të zgjerojnë objektin e Memorandumit të Mirëkuptimit në nisma në fushën e politikës së lëndëve narkotike;

5. Është e nevojshme të ndryshohet Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë së BE-së për të mbuluar, gjithashtu, objektivin e Programit të Drejtësisë të BE-së që lidhet me lëndët narkotike, kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë së BE-së ndryshohet si më poshtë:

1. Në nenin 2 (1) shtohet pika “d” si më poshtë:

“d) për të mbështetur iniciativat në fushën e politikës së lëndëve narkotike në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor dhe parandalimin e krimit, të lidhura ngushtë me objektivin e përgjithshëm të Programit, në masën që nuk mbulohen nga Fondi i Sigurisë së Brendshme për mbështetje financiare për bashkëpunimin policor, parandalimin dhe luftimin e Krimit dhe menaxhimit të krizës ose nga Programi për Shëndetin për Rritje”.

2. Pika 1 e shtojcës 1 të Memorandumit të Mirëkuptimit për Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Republikës së Shqipërisë në Programin e Drejtësisë zëvendësohet si më poshtë:

“1. Kontributi financiar që Shqipëria duhet t’i paguajë Buxhetit të Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në bashkëpunimin gjyqësor, trajnimin gjyqësor, aksesin në drejtësi dhe nismat e lidhura me lëndët narkotike, të Programit janë:

41 674 euro për vitin 2017 (duke përfshirë 6 000 EURO për objektivin “d”);

43 260 euro për vitin 2018 (duke përfshirë 6 000 EURO për objektivin “d”);

44 974 euro për vitin 2019 (duke përfshirë 6 000 EURO për objektivin “d”);

46 662 euro për vitin 2020 (duke përfshirë 6 000 euro për objektivin “d”).”.

Neni 2

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Bërë në Tiranë, më 12.2.2018

Për Republikën e Shqipërisë

Ministër i Brendshëm

Fatmir Xhafaj

Për Komisionin Evropian,

në emër të Bashkimit Evropian

Komisioner për Migracionin

(Çështjet e Brendshme dhe Shtetësinë)

Dimitris Avramopoulos

¹ OJ L 192, 22.7.2005, f. 2

² OJ L 354, 28.12.2013, f. 73